

## Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) në Kosovë

### POLITIKA TARIFORE

Prill 2025

Kjo *Politikë Tarifore* përcakton politikën aktuale tarifore të ARRU-së. Ajo është përgatitur për procesin e përcaktimit të tarifave për periudhën 2026-2028 dhe zëvendëson dokumentet e mëparshme të politikave tarifore që kanë qenë të zbatueshme për përcaktimet e mëparshme tarifore. Kjo politikë tarifore do të mbetet në fuqi për përcaktimet e ardhshme të tarifave, me përjashtim të rasteve kur kërkohen ndryshime nga ARRU.

#### Misioni

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe eficiente të shërbimeve të ujit për të gjithë konsumatorët në Kosovë.”

#### Vizioni

“Rregullimi i sektori i ujit në mënyrë transparente dhe të paanshme, në përputhje me praktikat e mira evropiane, që siguron që ndërmarrjet e ujësjellësit të ofrojnë një shërbim cilësor, të qëndrueshëm, të besueshëm dhe të përballeshëm në tërë territorin e Kosovës, duke respektuar si mjedisin ashtu edhe shëndetin publik.”

#### Përmbajtja

Parathënie .....	1
Dokumentet shoqërues të rëndësishëm .....	1
Përkufizimet dhe akronimet .....	2
1 Baza ligjore .....	4
2 Objektivat e politikës .....	4
3 Juridiksioni.....	4
4 Kërkesa për të ardhura dhe rikuperimi i kostos .....	5
5 Struktura e kapitalit, vlera dhe kthimi .....	6
6 Mbështetja për familjet me të ardhura të ulëta .....	7
7 Strukturat e reflektimit të kostos dhe tarifave .....	8
8 Zgjerimi i shërbimeve.....	9
9 Nivelet e shërbimit dhe mjedisi .....	10

## Parathënie

---

Ky rishikim i Politikës Tarifore ka për qëllim të reflektojë ndryshimet dhe përmirësimet e fundit në procesin e përcaktimit të tarifave pas konsultimit publik të mbajtur në janar të viti 2024 dhe vendimeve rregullore të mëpasshme që u janë komunikuar paraprakisht KRU-ve para rishikimit të tarifave për periudhën 2026-2028. Këto ndryshime përfshinin:

- Heqjen e përshpejtuar të ndër-subvencionimeve.
- Prezantimin e tarifave fikse, bazuar në madhësitë e ujëmatësve.
- Prezantimin e tarifave për përmirësimin e infrastrukturës jashtë vendit.
- Prezantimin e tarifave për ujërat e ndotura të vlerësuara, kur gjenerimi i ujërave të ndotura nuk lidhet me konsumimin e ujit nga KRU.
- Prezantimin e tarifave për ujërat e ndotura, për të pasqyruar cilësinë e ujërave të ndotura për konsumatorë të veçantë jo-shtëpiak.
- Tarifat të pasqyrojnë pritshmëritë e arsyeshme në reduktimin e humbjeve të dukshme.
- Tarifat për të pasqyruar kompensimin për konsumatorët për investime të përfshira në rishikimet e mëparshme, por që nuk janë realizuar.

Ky rishikim i *Procedurës Tarifore* hyn në fuqi për periudhën e rishikimit të tarifave për periudhën 2026-2028 dhe më pas do t'iu nënshtrohet ndryshimeve të mëtejshme sipas nevojës.

## Dokumentet shoqërues të rëndësishëm

---

*Politika Tarifore* duhet të lexohet së bashku me dokumentet e mëposhtme:

- Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit (i ndryshuar)
- Rregullorja e ARRU-së për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit, Ujërave të Zeza dhe Furnizimin me Ujë me shumicë në Kosovë (2012, i ndryshuar) [që do të ndryshohet për rishikimin e tarifave për periudhën 2026-2028]
- Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator (V02 2011) [që do të ndryshohen për rishikimin e tarifave për periudhën 2026-2028]
- Procedurat e Shqyrtimit të Tarifave 2012 – 2014 (2011 e ndryshuar) [që do të ndryshohen për rishikimin e tarifave 2026-2028]
- Udhëzuesi i Përdoruesit për Biznes Planin Rregullator dhe Modelin Tarifor (Versioni 2, 2011) [që do të ndryshohet për rishikimin e tarifave për periudhën 2026-2028]
- Konsultimi i ARRU-së mbi politikën e ardhshme tarifore, për furnizimin me ujë, janar 2024
- Raporti i ARRU-së për përgjigjet ndaj konsultimit mbi politikën e ardhshme tarifore për furnizimin me ujë, prill 2024

*Politika Tarifore* e rishikuar është zhvilluar për të mbështetur vendimet e fundit rregullore që u janë komunikuar KRU-ve nëpërmjet letrave të dërguara në dhjetor të vitit 2024, pas konsultimit lidhur me:

- Përmirësimin e informacionit të planifikimit afarist të bazuar në prova të verifikueshme
- Tarifat fikse, bazuar në madhësinë e lidhjes
- Tarifat për ujërat e ndotura industriale dhe udhëzimet shoqëruese
- Humbjet e ujit, që do të merren parasysh në përcaktimin e tarifave të ardhshme
- Kthimin mbi Bazën Rregullore të Aseteve (BRRA)
- Tarifat e vlerësuara të ujit
- Heqjen e ndër-subvencionimit
- Rimbursimin e parave, të paguara nga konsumatorët për investimet që nuk janë realizuar
- Tarifat për përmirësimin e rrjetit jashtë vendit dhe udhëzimet shoqëruese

## Përkufizimet dhe akronimet

<b>Humbjet e dukshme:</b> Konsumimi që nuk regjistrohet për shkak të gabimeve në ujëmatës dhe konsumatorëve të paregjistruar.
<b>Modeli Tarifor i Aseteve Kapitale:</b> Një mjet ekonomik konvencional, që përdoret nga rregullatorët për të përcaktuar kthimin nga kapitali që ndërlidhet me rrezikun për sektorin specifik që do të rregullohet.
<b>Mirëmbajtja kapitale:</b> Puna e planifikuar e realizuar nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit për të zëvendësuar dhe riparuar asetet e furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të Ndotura, për të siguruar një shërbim bazë për konsumatorët.
<b>Tarifat për kyçje:</b> Tarifa për konsumatorin ose zhvilluesin e projektit ndërtimor për të mbuluar kostot e lidhjes në rrjetin kryesor të konsumatorëve.
<b>Rikuperimi i kostos:</b> Kërkesa për të ardhura që është e mjaftueshme për të financuar aktivitetet e ofruesve të shërbimeve, plus një kthim i arsyeshëm nga kapitali që ata kanë investuar, duke ofruar ende një shërbim në përputhje me kërkesat e tyre ligjore dhe rregullatore.
<b>Reflektueshmëria e kostos:</b> Koncepti, ku çmimet për konsumatorët individualë ose grupet e konsumatorëve duhet, sa më praktikisht të jetë e mundur, të pasqyrojnë kostot që këta konsumatorë individualë ose grupe të konsumatorëve, ia imponojnë ofruesit të shërbimeve.
<b>Ndër-subvencionimi:</b> Një rregullim çmimesh ku një ose më shumë grupe të konsumatorëve paguajnë një çmim më të lartë për shërbimet e tyre për të subvencionuar çmimet për një ose më shumë grupe të tjera të konsumatorëve.
<b>Kontabiliteti i kostos aktuale:</b> Një metodë e kontabilitetit që paraqet transaksionet dhe raporton vlerat e tyre aktuale. Në vend që të shfaqen asetet sipas kostos së tyre historike (p.sh. çmimi i blerjes fillestare), minus zhvlerësimi, ku është e përshtatshme, asetet shfaqen sipas kostos së tyre aktuale (kostoja e zëvendësimit) në momentin e krijimit të llogarive. Kjo metodë e kontabilitetit përdoret në industrinë e ujit për shkak të natyrës së gjerë të asetëve kapitale dhe faktit që kostot historike nuk pasqyrojnë vlerën e vërtetë të asetëve.
<b>Zhvlerësimi i kostos aktuale:</b> Zhvlerësimi i llogaritur në përputhje me metodat e kontabilitetit të kostos aktuale.
<b>Niveli ekonomik i rrjedhjeve:</b> Niveli i rrjedhjeve në një sistem ku kostot e reduktimit të mëtejshëm të rrjedhjeve tejkalojnë përfitimet që do të realizohen nga reduktimi i rrjedhjeve.
<b>Përmirësimi:</b> Përmirësimi dhe zgjerimi i bazës së asetëve, përmes nivelit të përmirësuar të shërbimeve dhe/ose zgjerimit të sistemit.
<b>Tarifat fikse:</b> Komponenti i strukturës tarifore, që është një shumë fikse për muaj, pavarësisht nga vëllimi i ujit të konsumuar ose ujërave të ndotura të shkarkuara.
<b>Grantet:</b> Financimi i ofruar për investime, ose ofrimin e shërbimeve, për të cilat nuk kërkohet kthim. Investimi në infrastrukturë i financuar nga grantet nuk i shtohet as tarifës së rinovimit të infrastrukturës dhe as bazës rregullatore të asetëve.
<b>Asetet infrastrukturore:</b> Asetet (kryesisht asetet nëntokësore) që nuk kanë një jetëgjatësi të kufizuar dhe të cilat, nëse mirëmbahen siç duhet, do të jenë në gjendje të vazhdojnë të ofrojnë një nivel të pacaktuar shërbimi për konsumatorët për një kohë të pacaktuar.
<b>Tarifa për rinovimin e infrastrukturës:</b> Një dispozitë vjetore kontabël për shpenzimet për rinovimin e asetëve infrastrukturore (d.m.th. kryesisht nëntokësore) që ngarkohet në llogarinë e fitimit dhe humbjes rregullatore.
<b>Ligji:</b> Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit (i ndryshuar) themelon Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), si rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të ndotura.
<b>Asetet joinfrastrukturore:</b> Kryesisht asetet sipërfaqësore, siç janë punishtet e trajtimit të ujit, stacionet e pompimit dhe laboratorët e kompanisë, depotë dhe punëtoritë.
<b>Tarifat për përmirësimin e infrastrukturës jashtë vendit:</b> Tarifat për zhvilluesit e projekteve ndërtimore, për të mbuluar kostot kumulative të përforcimit të rrjetit të shkaktuar nga pronat e reja.
<b>Shpenzimet operative:</b> Shpenzimet e drejtpërdrejta operative lidhur me ofrimin e shërbimeve, duke përfshirë fuqinë punëtore; energjinë; kimikatet; materialet shpenzuese; shpenzimet e përgjithshme; taksat e pakthyeshme dhe shpenzimet tjera të përsëritura.
<b>Periudha e kontrollit të çmimeve:</b> Periudha (zakonisht trevjeçare) gjatë së cilës do të zbatohet rishikimi i tarifave.
<b>Humbjet reale:</b> Humbjet e ujit në rrjet i atribuohen rrjedhjeve fizike në tubacione.
<b>Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator (UKRR):</b> Rregullat e kontabilitetit të përcaktuara nga ARRU për regjistrimin e transaksioneve financiare në atë mënyrë që është në përputhje me procedurat dhe modelin e përcaktimit të tarifave.
<b>Baza rregullatore e asetëve (BRR):</b> Baza kapitale që përdoret për përcaktimin e kufijve të çmimeve. Përfaqëson vlerën fillestare të investimeve të bëra dhe borxhit, kapitalit qarkullues, kapitalit të qeverisë dhe shpenzimet e reja kapitale neto. Vlera e bazës rregullatore të asetëve llogaritet pasi të bëhet zhvlerësimi i kostos aktuale dhe rregullohet sipas inflacionit në secilën periudhë të re të rishikimit të çmimeve.

<b>Kthimi nga BRRA:</b> Një kthim i drejtë nga baza rregullatore e asetëve, i paraqitur si të ardhura vjetore dhe rritje e kapitalit nga investimi, e shprehur si përqindje e investimit fillestar.
<b>Kërkesa për të ardhura:</b> Të ardhurat vjetore të nevojshme për të financuar aktivitetet e KRU-ve, duke përfshirë kthimin nga kapitali. Ajo përfshin kostot operative; tarifën për rinovimin e infrastrukturës; zhvlerësimin e kostos aktuale; kthimin nga BRRA dhe kostot tjera sipas rastit.
<b>KRU:</b> Kompania Rajonale e Ujësjetësimit e rregulluar nga ARRU.
<b>Procedurat e përcaktimit të tarifave:</b> Procedura e detajuar e llogaritjes së tarifave për përcaktimin e tarifave, gjatë periudhës së caktuar të kontrollit të çmimeve.
<b>Përcaktimet e tarifave:</b> Një proces ku ARRU përcakton tarifën për periudhën e specifikuar të shqyrtimit të tarifave në përputhje me rregullat dhe procedurat e specifikuar.
<b>Tarifat e ndryshueshme:</b> Komponenti i strukturës tarifore, që bazohet në një normë për njësi për m <sup>3</sup> ujë të konsumuar.
<b>ARRU:</b> Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, rregullatori ekonomik i emëruar për sektorin e furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të ndotura në Kosovë.

## 1 Baza ligjore

- 1.1 Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit (i ndryshuar dhe plotësuar) themelon Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), si rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të ndotura.
- 1.2 Për qëllimet e kësaj politike, referenca në *Ligji Nr. 05/L-042* referohet si 'Ligji'.
- 1.3 *Neni 20* i Ligjit përcakton detyrat e ARRU-së në lidhje me përcaktimin dhe miratimin e tarifave të shërbimeve. Këto përfshijnë detyrime që tarifat e shërbimeve të plotësojnë disa kushte,
- Përcaktimet tarifore, për të marrë në konsideratë efikasitetin e ofruesve të shërbimeve.
  - Tarifat për kycje, duhet të plotësohen nga pranuesit e shërbimeve.
  - Tarifat duhet të jenë të mjaftueshme, për të mbuluar shpenzimet kapitale dhe ato të përsëritura.
  - Përgjegjësinë e institucioneve shtetërore, dhe jo të ofruesve të shërbimeve, për të ndihmuar konsumatorët me të ardhura të ulëta në mbulimin e kostove të furnizimit me ujë dhe të shërbimeve për ujërat e ndotura.
  - Respektimin e standardeve të aplikueshme, për shërbimet dhe mjedisin.
  - Tarifat e përcaktuara duhet t'i nënshtrohen një procesi konsultimi.
- 1.4 *Ligji* përcakton detyrimet e ofruesve të shërbimeve. Një parim themelor i politikës tarifore të ARRU-së është se tarifat duhet të jenë të mjaftueshme që ofruesit e shërbimeve të përmbushin detyrimet e tyre, me kusht që ata të arrijnë nivelet e efikasitetit që mund të priten në mënyrë të arsyeshme prej tyre.
- 1.5 Detyrimet ligjore të përcaktuara në *Ligj* mundësojnë një shkallë të diskrecionit rregullator të bazuar në gjykim profesional, në mirëkuptimin e subjekteve të rregulluara (dhe rrethanave të tyre specifike), si dhe në kriteret të tjera socio-ekonomike.

## 2 Objektivat e politikës

- 2.1 Interesat e palëve të ndryshme të interesit nuk përputhen domosdoshmërisht. Për shembull, interesat e konsumatorëve për tarifa të ulëta bien ndesh me interesin e investitorëve për qëndrueshmëri financiare. Është funksion i ARRU-së të sigurojë që, tarifat të ofrojnë një ekuilibër optimal mes këtyre interesave dhe të sigurojnë vlerën më të mirë të mundshme, duke përfshirë tarifat dhe cilësinë e përmirësuar të shërbimeve për shoqërinë. Kjo Politikë Tarifore është hartuar për të ofruar këtë ekuilibër të përgjithshëm më të mirë.

### 1 Objektivi i përgjithshëm i politikës

Objektivi kryesor i politikës tarifore të ARRU-së është të sigurojë një ekuilibër optimal, mes interesave të ndryshme të gjithë palëve të interesit, për të ofruar shërbime me cilësi të lartë, me çmimin më të mirë.

## 3 Juridiksioni

- 3.1 Ky dokument i politikës bazohet në mjedisin institucional aktual, sipas të cilit shtatë kompanitë rajonale të furnizimit me ujë (KRU) janë ofruesit e vetëm të licencuar të shërbimeve urbane të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të kanalizimit, të cilat operojnë dhe ofrojnë shërbime monopoliste lokale. Tarifat për shërbimet e furnizimit me ujë me shumicë të ofruara nga NPH 'Ibër Lepenci', për sektorët e energjisë elektrike dhe bujqësisë dhe për disa ofrues të shërbimeve të furnizimit me ujë, janë adresuar në një deklaratë të veçantë të politikave.

- 3.2 Juridiksioni fizik i zonave të shërbimit të ofruesve të shërbimeve nuk është statik dhe mund të kërkojë përshtatje për shkak të zonave të reja komunale të përfshira në zonat e furnizimit të ofruesve të shërbimeve.

## 2 Juridiksioni

Kjo Politikë Tarifore zbatohet për aktivitetet e shtatë kompanive rajonale të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të ndotura (KRU). Ajo nuk zbatohet për shërbimet e furnizimit me ujë me shumicë të ofruara nga NPH 'Ibër Lepenci'.

Kjo Politikë Tarifore njeh faktin se juridiksionet fizike të ofruesve të shërbimeve janë subjekt i ndryshimeve herë pas here dhe ndikimet në të do të merren parasysh gjatë procesit të përcaktimit të tarifave.

## 4 Kërkesa për të ardhura dhe rikuperimi i kostos

### 4.1 Përkufizimet

- 4.1 Kërkesat e përgjithshme për të ardhurat e ofruesve të shërbimeve, duhet të jenë të mjaftueshme, që ofruesit e shërbimeve të financojnë aktivitetet e tyre në përputhje me detyrimet e tyre ligjore dhe të sigurojnë një kthim të arsyeshëm nga kapitali që kanë investuar. *Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator (UKRR)* dhe *Procedurat e Përcaktimit të Tarifave* duhet të ofrojnë një metodologji të detajuar se si kjo zbatohet në procesin e përcaktimit të tarifave.

### 3 Përkufizimi i rikuperimit të kostos

Kërkesa për të ardhura përkufizohet si një rrjedhë e të ardhurave që është e mjaftueshme, për të financuar aktivitetet e ofruesve të shërbimeve, plus një kthim të arsyeshëm nga kapitali i investuar prej tyre, por që ende ofron një shërbim në përputhje me kërkesat e tyre ligjore dhe rregullatore.

### 4.2 Pritshmëritë për eficiencë

- 4.2 Tarifat duhet të pasqyrojnë pritshmëri reale, por megjithatë sfiduese, për përmirësimin e eficiencës nga ofruesit e shërbimeve. Pritshmëritë do të përcaktohen në planet afariste të ofruesve të shërbimeve që mbështesin aplikimet e tyre tarifore dhe do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga ARRU.

### 4 Pritjet për përmirësimin e eficiencës

KRU-të do të paraqesin në planet e tyre afariste, detaje të pritshmërive të propozuara për përmirësimin e eficiencës. Këto plane, do t'i nënshtrohen shqyrtimit dhe miratimit nga ARRU. Monitorimi i rregullt i performancës, kundrejt pritshmërive të eficiencës, do të përbëjë një aspekt kryesor të aktiviteteve monitoruese të ARRU-së.

### 4.3 Rikuperimi i shpenzimeve për investime kapitale

- 4.3 Qasja rregullatore për rikuperimin e investimeve kapitale, përfshin disa metodologji dhe janë përshkruar në detaje në UKRR.
- Zhvlerësimi, nuk do të zbatohet për asetet e financuara ose të dhuruara, pasi kjo, do të rezultojë, që ofruesit e shërbimeve të paguhen dy herë për të njëjtin investim.
  - Investimet e reja për përmirësimin e shërbimeve do t'i shtohen vlerës së kapitalit rregullator, por zhvlerësimi do të ngarkohet vetëm për asetet joinfrastrukturore (mbi tokë). Zhvlerësimi nuk zbatohet për asetet infrastrukturore (nëntokësore) dhe vlerat e tyre do të ruhen përjetësisht.
  - Mirëmbajtja kapitale (riparimi dhe zëvendësimi) i infrastrukturës, do të konsiderohet si shpenzim, dhe do të reflektohet në tarifa, bazuar në planet e menaxhimit të aseteve infrastrukturore.
  - Kur ngarkohet zhvlerësimi (për astet joinfrastrukturore), ai do të llogaritet mbi bazën e kontabilitetit të kostos aktuale, që për thjeshtësi do të bazohet në kostot historike të rregulluara nëpërmjet një formule të indeksimit të çmimeve të konsumit.

#### 5 Rikuperimi i kostove për investime kapitale

Investimet kapitale, të realizuara nga ofruesit e shërbimeve, do të kthehen përmes zbatimit të UKRR-së. Mirëmbajtja kapitale e asetëve infrastrukturore, përfshihet në tarifa në të njëjtën mënyrë si shpenzimet operative. Për asetet joinfrastrukturore, zbatohet zhvlerësimi sipas kostos aktuale. Zhvlerësimi, kur aplikohet, duhet të zbatohet vetëm për ato asetë që janë financuar nga vetë ofruesit e shërbimeve, përkatësisht, zhvlerësimi nuk aplikohet për asetet e financuara nga grantet.

### 4.4 Investimet kapitale të përfshira në tarifa por që nuk janë realizuar

- 4.4 KRU-të kanë përfshirë, në periudhat e mëparshme të kontrollit të çmimeve, propozime të rëndësishme për investime kapitale në aplikimet e tyre për tarifa, por një pjesë e konsiderueshme e këtyre investimeve nuk është realizuar. Pas konsultimit të zhvilluar në janar të vitit 2024, rishikimet pasuese të tarifave do të përfshijnë një rregullim në tarifa, për të reflektuar investimin aktual, në periudhën paraprake të shqyrtimit, në krahasim me atë që ishte përfshirë në propozimin e tarifave. Nëse investimi aktual rezulton të jetë më i ulët, sesa ishte propozuar, rishikimi pasuesi tarifave, do të përfshijë një zbritje në tarifa, për të reflektuar atë që konsumatorët kanë paguar por nuk u është ofruar. Në të kundërtën, nëse investimi rezulton të jetë më i madh sesa ishte propozuar dhe është i justifikuar, rishikimi pasues i tarifave do të përfshijë një rritje për të reflektuar atë investim shtesë. Ky proces do të fillojë me përcaktimin e tarifave për periudhën 2029-2031.

#### 6 Barazimi dhe rregullimet e investimeve kapitale

Duke filluar nga rishikimi i tarifave për periudhën 2029-2031, tarifatat do të përfshijnë një rregullim për të marrë parasysh ndikimet tarifore të dallimit ndërmjet investimeve kapitale të planifikuara dhe atyre reale (duke përfshirë rinovimet e infrastrukturës) në periudhat e mëparshme të rishikimit.

## 5 Struktura e kapitalit, vlera dhe kthimi

### 5.1 Struktura e kapitalit

- 5.1 Teoria konvencionale ekonomike, thekson që, struktura e kapitalit nuk ka asnjë ndikim në performancën e biznesit dhe si e tillë struktura e kapitalit, është më shumë çështje e menaxhimit të ofruesit të shërbimeve sesa shqetësim rregullator. Rrjedhimisht, kthimi nga kapitali do të bazohet në një kthim në totalin e BRRAsë.

#### 7 Struktura e kapitalit

Struktura e kapitalit (ekuitet: borxh) i ofruesve të shërbimeve, nuk do të ketë ndikim në përcaktimin e tarifave, në atë që kthimi do të përcaktohet bazuar në totalin e BRRAsë, pavarësisht se si financohen asetet (përveç granteve dhe asetëve të dhuruara të cilat nuk përfshihen në BRRAsë).

### 5.2 Baza rregullatore e asetëve (BRRAsë)

- 5.2 Baza rregullatore e asetëve (BRRAsë), përkufizohet si vlera e aktiveve, mbi të cilat mund të fitohet një kthim. Vlera fillestare e BRRAsë u përcaktua për periudhën e shqyrtimit të tarifave për vitet 2009-2011 dhe është rregulluar në çdo periudhë rishikimi që nga ajo kohë për të përfshirë të gjitha investimet e mëvonshme minus zhvlerësimin, kur është e aplikueshme, dhe është rritur ndjeshëm në vlera të kostos aktuale në përputhje me parimet e kontabilitetit të kostos aktuale.

#### 8 Baza rregullatore e asetëve (BRRAsë)

BRRAsë përkufizohet si vlera fillestare e BRRAsë, plus të gjitha investimet e reja neto (pas zhvlerësimit) të përshtatura me vlerat e kostos aktuale.

### 5.3 Kapitali qarkullues

- 5.3 Kërkesat për kapital qarkullues të ofruesve të shërbimeve, konsiderohen të përfshihen në BRRAsë fillestare, të përshtatur me inflacionin. ARRU mban qëndrimin se lëvizja e kapitalit qarkullues është më tepër një

çështje menaxhimi sesa rregullatore. Rrjedhimisht, çdo ndryshim në kapitalin qarkullues nuk do të rezultojë në rregullime të BRRRA-së.

#### 9 Kapitali qarkullues

Kapitali qarkullues i ofruesve të shërbimeve përfshihet në BRRRA-në fillestare, të përshtatur me inflacionin. Ndryshimet në kapitalin aktual qarkullues, nuk do të rezultojnë në rregullime të BRRRA-së.

### 5.4 Kthimi nga BRRRA

- 5.4 Ofruesit e shërbimeve do të kenë të drejtën e një kthimi të drejtë nga BRRRA. Norma e kthimit do të përcaktohet bazuar në kthimin e duhur që lidhet me rrezikun përmes aplikimit të Modelit Tarifor të Aseteve Kapitale ose të ngjashme. Në mungesë të informacionit të duhur të tregut, ARRU mund të përdorë të dhëna zëvendësuese, p.sh. koston e kapitalit në tregjet e obligacioneve dhe të aksioneve në zonën e valutës euro dhe karakteristikat e rrezikut të industrisë së ujit siç zbatohen në mjedise të tjera të rregulluara.
- 5.5 ARRU ka shqyrtuar, kohët e fundit, prova që mbështesin konceptin se, kompanitë më të vogla mund të kenë kosto më të larta financimi se homologët e tyre më të mëdhenj. Kthimi i përcaktuar nga BRRRA do të pasqyrojë kosto të tilla më të larta financimi nëpërmjet aplikimit të një bonusi për kompanitë e vogla, kur është e përshtatshme.

#### 10 Kthimi nga BRRRA

BRRRA do të përcaktojë një kthim të përshtatshëm nga BRRRA të ofruesve të shërbimeve, duke u bazuar në të dhënat më të mira të disponueshme, duke përfshirë të dhënat nga mjedise ekonomike të ngjashme në Evropë. Kthimi i përcaktuar do të marrë parasysh madhësinë relative të KRU-ve dhe do të aplikohet një bonus për kompanitë e vogla, kur është e përshtatshme.

### 5.5 Tatimet

- 5.6 Kthimi nga kapitali do të përcaktohet mbi bazën 'para tatimit'. Tatimet mbi fitimet do të konsiderohen të përfshira në kthimin nga kapitali. Tatimet tjera të pakthyeshme, p.sh. TVSH-ja në faturat e papaguara, do të përfshihen si kosto në kërkesat për të ardhura dhe do të përfshihen në tarifë.

#### 11 Tatimet

Kthimi nga kapitali do të përcaktohet mbi bazën 'para tatimit'. Tatimet tjera të pakthyeshme, do të kalohen si kosto që do të përfshihen në procesin e përcaktimit të tarifave.

## 6 Mbështetja për familjet me të ardhura të ulëta

### 6.1 Roli i ofruesve të shërbimeve në lidhje me përgjegjësitë sociale

- 6.1 Ligji (neni 20, 3.5) thekson se tarifat duhet të përcaktohen duke marrë parasysh *përgjegjësinë e institucioneve qeveritare, jo të ofruesve të shërbimeve, për të ndihmuar konsumatorët me të ardhura të ulëta të paguajnë faturat e tyre*. Rrjedhimisht, ofruesit e shërbimeve duhet të lejohen të operojnë mbi baza plotësisht komerciale. Aktualisht, KRU-të aplikojnë një ndër-subvencionim, ku konsumatorët jo-shtëpiak subvencionojnë konsumatorët shtëpiak. Gjithmonë ka qenë politika tarifore e ARRU-së, që kjo të eliminohet me kalimin e kohës. Në vitin 2024, ARRU i udhëzoi KRU-të që të heqin ndër-subvencionet gjatë periudhës së shqyrtimit tarifor 2026-2028, d.m.th. ndër-subvencionimi nuk do të përfshihet në tarifa nga viti 2029 e tutje.

#### 12 Përgjegjësia sociale

Qeveria (lokale dhe qendrore) është agjencia përgjegjëse për plotësimin e nevojave të konsumatorëve në vështirësi, duke përfshirë ndihmën për të përballuar kostot e shërbimeve publike. Ndër-subvencionet ekzistuese, do të hiqen plotësisht, deri në fund të periudhës së kontrollit të çmimeve 2026-2028.

## 7 Strukturat e reflektimit të kostos dhe tarifave

### 7.1 Parimet e reflektimit të kostos

- 7.1 Teoria ekonomike konvencionale, thekson se çmimi që reflekton koston ofron shpërndarjen më efektive të burimeve, kur konsumatorët paguajnë koston e plotë të mallrave që ata konsumojnë. Për shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura, kjo do të thotë që, çmimet për çdo konsumator individual ose grup konsumatorësh, duhet të pasqyrojnë kostot aktuale që ia imponojnë ofruesit të shërbimeve, individualisht ose si grup. Shkalla e reflektimit të kostos, i nënshtrohet praktikës së arsyeshme të kostove dhe përfitimeve të masave të ndërmarra. Kjo politikë tarifore kërkon të zbatohë parimet e reflektimit të kostos, për aq sa është praktikisht e arsyeshme.

#### 13 Parimet e reflektimit të kostos

Tarifat dhe strukturat tarifore, do të vendosen për të maksimizuar reflektimin e kostos, për aq sa është praktikisht e arsyeshme. Ndryshimet në metodologjinë e përcaktimit të tarifave, do të kërkojnë për të demonstruar përmirësim të reflektimit të kostos.

### 7.2 Shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura – tarifave të veçanta

- 7.2 Tarifave për shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura, do të përcaktohen si shërbime të veçanta dhe nuk duhet të ketë ndër-subvencione ndërmjet dy shërbimeve. Prandaj, kostot dhe të ardhurat për të dy shërbimet do të regjistrohen veçmas, siç përcaktohet në UKRR me qëllim të përcaktimit dhe monitorimit të tarifave.

#### 14 Shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura si aktivitete të veçanta afariste

Tarifave për shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura, do të përcaktohen si shërbime të veçanta afariste dhe se nuk duhet të ketë ndër-subvencione ndërmjet këtyre dy shërbimeve.

### 7.3 Uniformiteti i tarifave në kuadër të çdo KRU-je

- 7.3 Edhe pse kostot e shërbimeve në kuadër të zonës së shërbimeve të një ofruesi të shërbimeve ka të ngjarë të ndryshojnë sipas sistemit dhe sipas qytetit, është e pamundur (pa sisteme komplekse të kontabilitetit) të përcaktohen tarifave të veçanta për secilën zonë. Rrjedhimisht, tarifave duhet të jenë uniforme në të gjithë zonën e shërbimeve, të çdo ofruesi të shërbimeve. Megjithatë, nëse një zonë e re miratohet nga një ofruesi të shërbimeve që ka tarifave aktuale më të ulët se tarifa e ofruesit të shërbimeve, rregullimi i tarifës së ofruesit të shërbimeve mund të ketë nevojë të shpërndahet në disa vite për të shmangur tronditjen e çmimeve.

#### 15 Uniformiteti i tarifave

Tarifave do të jenë uniforme në të gjithë zonën e shërbimeve, të çdo ofruesi të shërbimeve, përveç rasteve kur zona të reja të shërbimeve, miratohen nga një ofruesi të shërbimeve, dhe tarifa duhet të rritet, për të arritur nivelin tarifës aktuale të ofruesit të shërbimeve, ku me këtë rast mund të jetë e përshtatshme një rritje progresive (për jo më shumë se tre vjet).

### 7.4 Tarifave fikse dhe të ndryshueshme

- 7.4 Tarifave për shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura, aktualisht përfshijnë një përzierje tarifash fikse dhe të ndryshueshme, por këto nuk bazohen në arsyetimin e reflektimit të kostos. Konsultimi i janarit të vitit 2024, ka propozuar një qasje alternative ndaj tarifave fikse, bazuar në kostot e ofrimit të shërbimeve, që nuk kanë lidhje me vëllimin e konsumit të ujit ose ujërave të ndotura të krijuara. Këto kosto lidhen me leximin e ujematësve, faturimin, arkëtimin e të ardhurave dhe një pjesë të shpenzimeve të përgjithshme përkatëse. Gjithashtu përfshihen kostot e ndërrimit periodik të ujematësve, që ndërlidhet

drejtpërdrejt me madhësinë e kycjes. Rrjedhimisht, ARRU ka udhëzuar KRU-të, që të miratojnë një tarifë fikse në kuadër të strukturës tarifore, që bazohet në madhësinë e kycjes me bilancin e të ardhurave të kërkuara dhe të rikuperuara përmes tarifave të ndryshueshme, bazuar në vëllimin e ujit të shitur dhe/ose të vlerësuar.

- 7.5 ARRU ka marrë parasysh ndikimin në familjet me të ardhura të ulëta dhe ka arritur në përfundimin se familjet më të varfra janë ato që janë familje të mëdha, ku konsumimi është pa dyshim i lartë. Faturat e ujit dhe ujërave të ndotura për këto familje, do të jenë më të ulëta, me një tarifë fikse, se sa do të ishin nëse të gjitha kërkesat për të ardhura, do të mbulohehin vetëm me tarifat për vëllimin e konsumuar.
- 7.6 Konsumatorët që përdorin sistemin e kanalizimeve, por që nuk janë të kyçur në sistemin e furnizimit me ujë, do të jenë subjekt i një tarife fikse që mbulon kostot e faturimit dhe administrimit, por jo zëvendësimin e ujëmatësve.

#### 16 Tarifat fikse bazuar në madhësinë e kycjes

Struktura tarifore për shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet ujërave të ndotura përbëhet nga një kombinim tarifash fikse dhe të bazuara në vëllim. Tarifa fikse, përcaktohet në përputhje me madhësinë e kycjes dhe, për aq sa është e mundur, do të përcaktohet në përputhje me kostot e ofrimit shërbimeve, që nuk ndërliken me vëllimin, duke përfshirë leximin e ujëmatësve, faturimin, arkëtimin e të ardhurave, shpenzimet e administratës dhe zëvendësimin periodik të ujëmatësve. Konsumatorët që përdorin vetëm sistemin e ujërave të ndotura, do të jenë subjekt i një tarife fikse, për të mbuluar kostot e faturimit dhe administrimit.

### 7.5 Tarifat volumetrike

- 7.7 Tarifa volumetrike për furnizimin me ujë përcaktohet si kërkesë e të ardhurave neto për furnizimin me ujë (pas zbritjes së tarifave për kycje, barazimit të shpenzimeve të kaluara të investimeve kapitale dhe komponentëve të tjerë të të ardhurave) pjesëtuar me vëllimin e ujit të shitur (subjekt i rregullimeve për eficiencën e arkëtimin të së ardhurave).
- 7.8 Tarifa volumetrike për shërbimet e ujërave të ndotura, përcaktohet në mënyrë të ngjashme, por kërkesa për të ardhura nga shërbimet e ujërave të ndotura, pjesëtohet me shumën e vëllimit të ujit të shitur dhe çdo sasi shtesë të vlerësuar të ujit ku, për disa konsumatorë, vëllimi i ujërave të ndotura të gjeneruara nuk është i lidhur drejtpërdrejt me vëllimin e ujit të furnizuar nga KRU-të. Konsumatorët, që janë subjekt i vëllimeve të vlerësuar të ujërave të ndotura, do të ngarkohen për shërbimet e ujërave të ndotura, bazuar në tarifën e ujërave të ndotura, shumëzuar me vëllimin e ujit të futur që, bazohet me shkarkimin e vlerësuar të ujërave të ndotura, duke përdorur faktorët mesatar të kthimit për KRU.

#### 17 Strukturat tarifore të furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura

Tarifat për furnizimin me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura do të përcaktohen bazuar në vëllimin e ujit të shitur, përveç për konsumatorë specifikë, ku vëllimi i ujërave të ndotura të krijuar, nuk ka lidhje me ujin hyrës nga KRU, dhe në këto raste, KRU do të përcaktojë rrjedhjet e vlerësuar të ujërave të ndotura dhe në këtë mënyrë do të përcaktojë një vëllim të vlerësuar të ujit hyrës për qëllime faturimi.

## 8 Zgjerimi i shërbimeve

### 8.1 Tarifat për kycje

- 8.1 Struktura aktuale e tarifave, lejon që tarifat për kycje, të mbulojnë kostot e kycjes në rrjetin kryesor të konsumatorit. Qëndrimi i ARRU-së është se tarifat e tilla do të mbeten në fuqi.

#### 18 Tarifat për kycje

Ofruesit e shërbimeve mund të zbatojnë tarifa të kycjes për të mbuluar shpenzimet për mbërthyes, tubin e shërbimit, valvulën, ujëmatësin etj., si dhe tarifat administrative etj., ashtu siç aplikohen aktualisht. Këto tarifa mund të paguhen nga qeveria ose agjencitë donatore për rastet sociale.

## 8.2 Rikuperimi i investimeve kapitale për zgjerimin e rrjetit

- 8.2 Procesi aktual i përcaktimit të tarifave, është i tillë, që të gjithë konsumatorët ekzistues paguajnë për zgjerimin e rrjetit. Konsultimi i janarit të vitit 2024, konsideroi se ky proces nuk ishte në përputhje me parimin e reflektimit të kostos. Pas këtij konsultimi, ARRU ka udhëzuar KRU-të të zbatojnë *'tarifat për përforcimin e infrastrukturës jashtë vendit'* që do t'u ngarkohen zhvilluesve për kyçje të reja - neto. Të ardhurat nga këto tarifa do të trajtohen si kontribut i zhvilluesve ndaj kostos kapitale të përmirësimit të rrjetit. Kjo do të sigurojë që, kostot e zgjerimit të rrjetit, do të barten nga zhvilluesit që u vendosin kosto të tilla KRU-ve. Si rrjedhojë, tarifat për konsumatorët ekzistues, do të jenë më të ulëta sesa do të ishin në forma tjera.

### 19 Tarifat për përmirësimin e infrastrukturës jashtë vendit

Zhvilluesit e projekteve të reja ndërtimore do t'i nënshtrohen *tarifave për përforcimin e infrastrukturës jashtë vendit*, për të kontribuar në një pjesë të drejtë të kostove të përforcimit të rrjetit, të shkaktuar nga kërkesa për zhvillime të reja.

## 9 Nivelet e shërbimit dhe mjedisi

### 9.1 Nivelet e shërbimit

- 9.1 Edhe pse nivelet e shërbimit në tërë Kosovën janë përmirësuar vitet e fundit, ato shpeshherë mbeten nën nivelet minimale të pranueshme (standardet e BE-së apo të ngjashme). Është e diskutueshme se konsumatorët që përballen me nivele të ulëta të shërbimit duhet të paguajnë një tarifë më të ulët për njësi, krahasuar me ata që gëzojnë një nivel më të lartë të shërbimit. Megjithatë, është jopraktike që të strukturohen tarifat mbi këtë bazë dhe do të përdoren më mirë mekanizmat kompensues alternativë.

### 20 Nivelet e shërbimit

Tarifat nuk do të ndryshojnë sipas nivelit të shërbimit. Megjithatë, ARRU do të përdorë kompetencat e saj rregullatore për të zbatuar përputhjen me standardet minimale të cilësisë dhe shërbimit.

### 9.2 Nxjerrja e ujit dhe tarifat për ujin e papërpunuar

- 9.2 Ofruesit e shërbimeve aktualisht paguajnë tarifa për nxjerrjen e ujit të papërpunuar, qoftë për qeverinë në formë takse apo për furnizuesit me ujë të papërpunuar me shumicë. ARRU e mbështet vendosjen e këtyre tarifave, mbi bazën e mbulimit të kostos ekonomike të ujit dhe stimujve që ato krijojnë për reduktimin e humbjeve të ujit.

### 21 Tarifat për nxjerrjen e ujit dhe ujin e papërpunuar

Vendosja e tarifave për nxjerrjen e ujit të papërpunuar mbështetet nga ARRU

### 9.3 Menaxhimi i humbjeve të ujit

- 9.3 Shkalla e humbjeve të ujit, si ato reale ashtu edhe ato të dukshme, ka mbetur pothuajse e pandryshuar që nga shqyrtimi i parë trevjeçar, i periudhës 2009-2011. KRU-të kanë bërë pak ose aspak përpjekje për të reduktuar këto humbje, që nga viti 2002 dhe madje edhe pas 15 viteve ato nuk janë në gjendje të përcaktojnë natyrën e humbjeve- nëse janë reale apo të dukshme. Një analizë e përafërt nga ARRU, sugjeron se shumica e humbjeve janë të dukshme, pra si pasojë e pasaktësisë së ujëmatësve, konsumatorëve pa ujëmatës (të cilët nuk mund të faturohen për shërbimet e ujit për arsye ligjore) dhe konsumatorëve të paregjistruar. Për rishikimet e ardhshme tarifore, duke përfshirë periudhën e ardhshme 2026-2028, ARRU, do të marrë parasysh pritshmëritë për reduktimin e humbjeve të dukshme, përmes programeve për rregullimin e konsumatorëve aktual të paregjistruar, instalimit të ujëmatësve dhe riparimit / zëvendësimit të ujëmatësve të dëmtuar. Kjo do të sjellë rritje të numrit të kyçjeve të reja të rregullta me ujëmatës dhe rritje të niveleve mesatare të konsumit. Këto efekte, nga

ana tjetër, do të rezultojnë me tarifa më të ulëta, sesa do të ishin në forma tjera. ARRU vlerëson se humbjet e dukshme duhet të afrohen me nivelin zero me kalimin e kohës.

- 9.4 Reduktimi i humbjeve reale (rrjedhjeve fizike) do të kërkojë përpjekje të gjera shkencore, me qëllimin të arritjes së 'nivelit ekonomik të rrjedhjeve', d.m.th pikës kur kostoja e reduktimit të mëtejshëm të rrjedhjeve, e tejkalon përfitimin. ARRU pret që KRU-të të bëjnë përpjekjet më të mira për të reduktuar humbjet reale në *nivelin ekonomik të rrjedhjeve*. ARRU do të shqyrtojë ndërmarrjen e masave ndëshkuese, duke përfshirë gjokat financiare, nëse vlerësohet se KRU-të nuk po e arrijnë këtë objektiv.

#### 22 Menaxhimi i humbjeve të ujit

Tarifat për furnizim me ujë dhe të shërbimeve të ujërave të ndotura, do të bazohen në një pritshmëri për reduktimin e humbjeve të dukshme, që do të sjellë tarifa më të ulëta se në rastet tjera.

ARRU pret që KRU-të, të bëjnë përpjekjet më të mira, për të ulur humbjet reale në *nivelin ekonomik të rrjedhjeve* dhe mund të aplikojnë masa ndëshkuese, nëse vlerësohet se KRU-të nuk po e arrijnë këtë objektiv.

#### 9.4 Tarifat për ujërat e ndotura bazuar në cilësinë e efluentit të ujërave të ndotura

- 9.5 Konsultimi i janarit të vitit 2024 propozoi vendosjen e tarifave të ujërave të ndotura për konsumatorë të caktuar jo-shtëpiak, të bazuara në cilësinë e efluentit të ujërave të ndotura. Kjo do të reflektojë kosto më të larta (ose më të ulëta) të trajtimit, që disa konsumatorë mund t'ia imponojnë KRU-ve. Tarifat do të vendosen, për të mbajtur reflektimin e kostos së trajtimit. Këto tarifa do të dërgojnë sinjale çmimesh ekonomikisht eficientë që do të rezultojnë në vendimmarrje ekonomikisht eficientë nga konsumatorët industrialë në lidhje me investimet në trajtimin paraprak.
- 9.6 KRU-të janë udhëzuar që të përcaktojnë konsumatorët që mund të hyjnë në këtë kategori, me qëllim të vendosjes së tarifave të tyre në përputhje me rrethanat. Konsultimi, mbajti qëndrimin se KRU-të individuale mund të kërkojnë të aplikojnë për përjashtim nga kjo kërkesë nëse konsiderojnë se numri i konsumatorëve të prekur është aq i vogël, sa përfitimet janë minimale, në raport me kostot e zbatimit.

#### 23 Tarifat për ujërat e ndotura bazuar në cilësinë e efluentit

Tarifat për ujërat e ndotura për konsumatorë të veçantë jo-shtëpiak do të bazohen në cilësinë e efluentit të ujërave të ndotura, kur është e aplikueshme. Këto tarifa do të reflektojnë koston, për aq sa është praktikisht e arsyeshme, për të inkurajuar vendimmarrje ekonomikisht eficientë, nga konsumatorët e prekur. KRU-të mund të aplikojnë për përjashtim nga kjo kërkesë, nëse përfitimi - neto, është minimal, në lidhje me masat e zbatimit.